



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E SHËNDETËSISË



#VAKSINOHU
#MbrojVeten



Informata mbi vaksinat kundër COVID-19 dhe gripit sezonal

COVID-19 dhe gripi sezonal janë sëmundje ngjitëse të rrugëve të frymëmarrjes, të cilat shkaktohen nga viruse të ndryshme. COVID-19 shkaktohet nga infeksioni me koronavirus (SARS-CoV-2) i identifikuar për herë të parë në 2019, kurse gripi sezonal shkaktohet nga infeksioni me virus të gripit.

Krahasuar me gripin sezonal, COVID-19 mund të shkaktojë sëmundje më të rëndë të disa njerëz. Personave të infektuar me COVID-19 mund t'u duhet më shumë kohë për të shfaqur simptoma dhe mund të jetë ngjitës për periudha më të gjata kohore, në krahasim me gripin sezonal.

Dallimi midis COVID-19 dhe gripit sezonal nuk mund të vërehet vetëm nga simptomat, për shkak të ngjashmërive të mëdha mes tyre. Nevojiten teste specifike për të treguar se me cilin virus jeni infektuar.

Njerëzit e infektuar me COVID-19 dhe grip sezonal në të njëjtën kohë mund të sëmuren më rëndë sesa njerëzit me vetëm njërin shkaktar.

Vaksinimi kundër COVID-19 dhe gripit sezonal

Personave të moshës 65+ dhe grupeve të rrezikut mund të ju ofrohet vakcina kundër COVID-19 dhe gripit sezonal në të njëjtin kohë për shkak se është e sigurt dhe efektive për t'u dhënë në këtë mënyrë. Vaksinimi me këto dy vakcina ofron mbrojtjen më të mirë përpara muajve të dimrit, kur viruset janë zakonisht në valën e paraqitjes. Është vërtetë e rëndësishme që grupet me rrezik të shtuar të vaksinohen pasi mund të përballen me sëmurje të rëndë dhe komplikime.

Vaksinat kundër COVID-19 dhe gripit sezonal do të jepen në të gjitha qendrat e vaksinimit në secilën komunë.